



Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

MISIONI NË KOSOVË

DEPARTAMENTI PËR MONITORIM

Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik

Raporti mujor - Janar 2008

Mungesa e aktvendimit për fillim të hetimeve përbën shkelje të ligjit vendor

Misioni i OSBE-së në Kosovë është i brengosur për atë se në disa raste të monitoruara, prokuroritë kishin zhvilluar hetimet pa lëshuar paraprakisht aktvendim për fillimin e hetimeve, siç është e paraparë me ligj.

Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës (Kodi i Procedurës Penale)¹ përcakton se “Hetim[i] fillohet me aktvendim të prokurorit publik. Aktvendimi përcakton personin kundër të cilit kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që e justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, dhe provat dhe informacionet e mbledhura deri në atë moment.”²

Megjithatë, OSBE ka monitoruar disa raste në të cilat prokurorët kanë ndërmarr masa hetimore pa e lëshuar paraprakisht aktvendimin për fillimin e hetimeve:

Gjatë rrjedhës së hetimeve kundër dy shqiptarëve të Kosovës të dyshuar për kryerje të veprës penale lëndim i lehtë trupor³ ndaj një serbi të Kosovës, me 3 dhe 4 dhjetor 2007 prokurori komunal ndërmori veprime hetimore (dëgjimi i dy të pandehurve, urdhri për ekzaminim mjekësor të viktimës). Me 12 dhjetor 2007, ai ngriti propozim akuzë kundër të pandehurve. Me gjithë këtë, ai kurrë nuk kishte lëshuar aktvendim për fillim të hetimeve.

Në një rast që përfshinte një të dyshuar për trafikim me qenie njerëzore⁴ dhe dhunim,⁵ në nëntor 2007 prokurori i qarkut zhvilloi hetime të cilat dërguan në arrestimin e të pandehurit. Me 26 nëntor 2007, gjyqtari i procedurës paraprake i urdhëroi një muaj paraburgim ndaj të dyshuarit. Prokurori lëshoi aktvendimin për fillimin e hetimeve pas tri ditëve, me 29 nëntor 2007.

Në disa raste të hetuara nga zyrat e Prokurorive Komunale në një regjion, gjatë vitit 2007, prokurorët ndërmorën veprime hetimore rutinore (siç janë marrja në pyetje e të pandehurve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve) pa marrë aktvendim për fillimin e hetimeve. Në veçanti në një rast, ku përfshiheshin veprat penale, marrje e ryshfetit,⁶ dhe shpërdorim i pozitës zyrtare ose autoritetit,⁷ prokurori komunal tha se qëllimisht nuk kishte lëshuar aktvendimin për shkak se dëshironte të sigurohet lidhur me kualifikimin e veprave të cilat po

¹ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/26, 6 korrik 2003.

² Kodi i Procedurës Penale, Neni 221(1).

³ 153, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, i shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2003/25, 6 korrik 2003 (Kodi Penal).

⁴ Neni 139, Kodi Penal.

⁵ Neni 193, Kodi Penal.

⁶ Neni 343(1), Kodi Penal.

⁷ Neni 339, Kodi Penal.

i hetonte.⁸ Vetëm pas dëgjimit të palës së dëmtuar dhe të të pandehurit me 23 tetor 2007 lëshoi aktvendimin të cilin e para-datoi 8 tetor 2007.

Aktvendimi për fillim të hetimeve nuk është vetëm thjeshtë formalitet. Përkundrazi, ai shërben si garanci për të pandehurin në atë se: (1) përcakton momentin prej të cilit afati i paraparë prej gjashtë muajve për përfundim të hetimeve duhet të kalkulohet,⁹ (2) parandalon prokurorin që të fillojë hetime kur nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm,¹⁰ (3) kufizon autorizimet hetimore të prokurorit në lidhje me vepër(at) të dhëna në aktvendim,¹¹ dhe (4) siguron se gjyqtari i procedurës paraprake është i caktuar dhe i njëjti është i njoftuar për hetimet në zhvillim,¹² duke parandaluar kështu prokurorin që të ndërmerret hetime për të cilat autoritetet gjyqësore nuk janë në dijeni.¹³

Duke ndërmarr veprime hetimore para marrjes së aktvendimit për fillim të hetimeve, prokurorët bënë shkelje të ligjit vendor me pasoja të cilat janë jo vetëm formale por edhe substanciale.

Për atë çka u tha më lartë, OSBE rekomandon që:

- Prokurorët të lëshojnë aktvendime për fillim të hetimeve para se të ndërmarrin çfarëdo veprimi hetimor.
- Gjyqtarët e procedurës paraprake të sigurojnë që aktvendimi për fillim të hetimeve të jetë pjesë e shkresave të lëndës para se ata të marrin vendime mbi çështjet gjatë procedurës paraprake.

Dështimi nga ana e kryetarit të kolegjit të mbaj rregullin gjatë seancave të shqyrtimit kryesor në rastet civile përbën shkelje të ligjit vendor

OSBE është e brengosur se dështimi i disa kryetarëve të trupave gjykues të mbajnë rregullin në sallat e gjykimit gjatë procedurës civile ka ndikim negativ në rrjedhën e procedurës e mbase edhe në dinjitetin e gjykatës.

⁸ Në të kundërtën, *racionalja* e nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale është që t'i lejohet prokurorit të fillojë hetimet vetëm në prani të dyshimit të arsyeshëm që një i pandehur i veçantë ka kryer ndonjë vepër specifike penale.

⁹ Qartazi, në mungesë të aktvendimit për fillim të hetimeve është e pamundur të përcaktohet (dhe kështu të vëzhgohet përputhshmëria) kohëzgjatja e hetimeve, që është e kufizuar (me mundësi zgjatjeje) në gjashtë muaj (shih nenin 225, Kodi i Procedurës Penale). Lëshimi me kohë i aktvendimit për fillim të hetimeve gjithashtu minimizon edhe vonesat në hetime.

¹⁰ Sipas nenit 221(1), aktvendimi duhet të pasqyrojë “rrethanat dhe faktet të cilat justifikojnë dyshimin e arsyeshëm për vepër penale.”

¹¹ Neni 222(1), Kodi i Procedurës Penale. Prokurori megjithatë mund t'i zgjerojë hetimet për vepra tjera penale dhe për të dyshuar të tjerë, por vetëm me autorizim të gjyqtarit të procedurës paraprake.

¹² Në fakt, sipas nenit 221(1) të Kodit të Procedurës Penale, “një kopje e aktvendimit të hetimit i dërgohet pa vonesë gjyqtarit të procedurës paraprake.”

¹³ Duke ja dërguar gjyqtarit të procedurës paraprake një kopje të vulosur të aktvendimit, mund gjithashtu t'i shërbej edhe qëllimit për përcaktim të gjykatës kompetente (shih nenin 33(1), Kodi i Procedurës Penale).

Në mënyrë që të ketë rrjedhë të duhur të procedurës gjyqësore, kryetari i kolegjit duhet të sigurojë që seancat e gjykimit të zhvillohen në rregull. Sipas Ligjit mbi Procedurën Kontestimore,¹⁴ është “[...] detyra e kryetarit të kolegjit që gjatë seancës kryesore të kujdeset për mbajtjen e rregullit në sallën e gjyqit dhe për dinjitetin e gjykatës.”¹⁵ Veç kësaj, “[...] në qoftë se personi që merr pjesë në proces ose personi i pranishëm gjatë shqyrtimit [...] pengon punën ose nuk u nënshtrohet urdhrave të kryetarit të kolegjit, [...] kryetari i kolegjit do ta qortojë. Po që se qortimi do të jetë i pasuksesshëm, kolegji mund ta largojë personin e qortuar nga salla e gjykimit ose ta dënojë me gjobë.”¹⁶

Përkundër këtyre dispozitave, OSBE ka monitoruar raste në të cilat kryetari i kolegjit dështoi të mbaj rregullin në sallën e gjykimit gjatë procedurave civile:

Në një rast para një gjykate komunale, gjashtë paditës parashtruan padi për vërtetim prone. Në seancën gjyqësore të datës 3 prill 2007 avokati i paditësve filloi disa diskutime jo-relevante me qëllimin e rastit. Për më tepër avokati e pengonte përfaqësuesin e të paditurit dhe dëshmitarët kur ata po i jepnin deklaratat e tyre. Përkundër faktit se sjellja dhe qëndrimi i avokatit pengonte rrjedhën normale të procedurës, gjyqtari dështoi të ndërmerri ndonjë masë që të rikthente rregullin në gjykatore.

Në një tjetër rast pranë një gjykate komunale, një paditës parashtrroi padi për dëbim. Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me 1 shkurt 2007 njëri nga të paditurit filloi të grindet me përfaqësuesin e paditësit ndërsa i padituri i dytë i bërtiste paditësit. Përderisa po ndodhte kjo kryetari i kolegjit bisedonte me ndihmësen juridike dhe nuk ndërmerri asnjë masë për të rikthyer qetësinë në gjykatore.

Në të dy shembujt, kryetarët e kolegjit dështuan të ndërmarrin çfarëdo veprimi të paraparë me ligj (siç janë qortimi i palëve ose dënimi me gjobë) në mënyrë që të sigurojnë procedurë të rregullt gjyqësore duke iu kundërvënë kështu obligimit pozitiv të tyre për të siguruar rrjedhë të rregullt gjykimi. Kjo gjithashtu mund të ketë efekt negativ ndaj dinjitetit dhe besueshmërisë të vetë gjykatës.

Rrjedhimisht, OSBE rekomandon që:

- Gjyqtarët të mbajnë rregullin gjatë seancave të gjykimit në raste civile përfshirë këtu, kur është e nevojshme, edhe zbatimin e masave të parapara me ligj për disiplinim të palëve.

¹⁴ Ligji mbi Procedurën Kontestimore, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, Nr 4/77-1478, 36/80-1182, 69/82-1596.

¹⁵ Neni 317, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.

¹⁶ Neni 318, Ligji mbi Procedurën Kontestimore.